



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE

Nr. 154/5 Prot.

Tiranë, më 02.03.2015

VENDIM

“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 19, datë 02/03/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/, , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 154/1 Prot., datë 18.02.2015, ndaj Autoritetit Publik/Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni”, sipas së cilës pretendon se është cenuar në të drejtën e tij për informim. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, në datë 04.02.2015 ka paraqitur pranë autoritetit publik/ Universitetit “Ismail Qemali”, kërkesën për informacion. Kërkuesi ka kërkuar ti vihen në dispozicion kopje të dokumenteve, konkretisht:

1. Ftesa dhe programi për seminare dhe takime ndërkombëtare datë 09.04.2012 deri në datë 28.04.2012, drejtuar Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, ku ka marrë pjesë dhe
2. Ftesa dhe programi i konferencës dërguar nga Universiteti SUNY-USA zhvilluar në datë 15.05.2013 deri më 28.05.2013, drejtuar Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, ku ka marrë pjesë dhe
3. Ftesa dhe programi i konferencës zhvilluar në datë 31.03.2014 deri në datë 10.04.2014, drejtuar Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, ku ka marrë pjesë dhe
4. Ftesa dhe programet e seminareve dhe takimeve ndërkombëtare zhvilluar në datë 31.08.2014 deri në datë 10.09.2014, drejtuar Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, ku ka marrë pjesë dhe
5. Referimet e pedagogëve në këto konferenca dhe të gjitha shpenzimet e rimbursimit, përfshirë bileta udhëtimi, fatura hoteli dhe çdo dokument tjetër që provon kryerjen e shpenzimeve nga fondet publike.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës rezulton se, kërkesa është trajtuar brenda afatit ligjor, konform nenit 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga Autoriteti Publik/Universiteti “Ismail Qemali”.

Në përgjigjen e dhënë nr. 195/1 datë 12/02/2015, Autoriteti Publik/Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, ka argumentuar se informacioni i kërkuar, në referim të shkronjës "I" të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" nuk është gjykuar si informacion i dobishëm për t'u bërë publik. Lidhur me kërkesën për shpenzimet e rimbursimit, përfshirë bileta udhëtimi, fatura hoteli dhe çdo dokument tjetër, Autoriteti Publik i konsideron të dhëna personale të cilat jepen vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave.

Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së dhe përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, me urdhrin nr.29, datë 26.02.2015 urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Gjatë inspektimit, Koordinatori ka shpjeguar se informacioni i kërkuar nga përmban të dhëna personale dhe se ka përfunduar qëllimi për të cilin këto të dhëna janë mbledhur.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se në kuptim të nenit 5 pika 1 shkronja "c" dhe nenit 27, pika 4 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të dhënat janë mbajtur për aq kohë sa ka përfunduar qëllimi për të cilin ato janë mbledhur dhe për këtë shkak ankuesi nuk mund të pajiset me to.

Ndërsa lidhur me kërkesën për shpenzimet e rimbursimit, përfshirë bileta udhëtimi, fatura hoteli dhe çdo dokument tjetër, Autoriteti Publik detyrohet t'i pasqyrojë në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit. Kërkesa për tu informuar lidhur me zëra të veçantë, apo detaje të shpenzimeve të Autoritetit Publik, është në vlerësim të këtij të fundit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrezuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

### **V E N D O S A:**

1. Rrëzimin tërësisht të ankesës nr. 154/1 Prot., datë 18.02.2015 të kundër Autoritetit Publik/Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ky vendim u dha sot në datë 02.03.2015.

